



Bazuar në Nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2010), nenin 20 paragrafi 1.3 dhe nenin 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare JoBankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2012, miratoi si vijon:

RREGULLORE MBI MENAXHIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktoj parimet bazë për identifikimin, matjen, kontrollin dhe menaxhimin e rrezikut operacional të bankave, strukturën dhe komponentët e tij, si dhe kërkesat mbikëqyrëse nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja (në vijim: *Bankat*), të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përdorura në Ligjin Nr.04/L-093 mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*), dhe/ose përkufizimet në vijim për qëllim të implementimit të kësaj rregulloreje:
 - a) *Rreziku Operacional* definohet si rrezik i humbjeve të shkaktuara nga proceset e brendshme të dështuara apo jo adekuate, njerëzve, sistemeve dhe ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin rrezikun ligjor, mirëpo përjashton rrezikun strategjik si dhe atë të reputacionit. Rreziku ligjor përfshin, por nuk është i kufizuar në ekspozimet ndaj gjobave, dënimeve apo masave ndëshkuese, që rezultojnë nga veprimet e mbikëqyrësit, si dhe çdo lloj tjetër i marrëveshjeve me palët individualisht. Edhe pse rreziku i reputacionit dhe rreziku strategjik nuk janë lehte të identifikueshëm, pritet që bankat të zhvillojnë teknika për menaxhimin e të gjitha aspekteve të rrezikut.
 - b) *Ngjarje materiale e rrezikut operacional* definohet si humbjet me vlerë materiale mbi apo baraz me 20% të kapitalit të klasit të I-rë.

Neni 3

Kërkesat

1. Bankat në pajtim me këtë rregullore, duhet të krijojnë një sistem të menaxhimit të rrezikut operacional, adekuat me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të tyre, me qëllim që në mënyrë efektive të identifikojnë, vlerësojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë/zvogëlojnë rrezikun operacional. Ky sistem mund të jetë në çfarëdo forme, por së paku duhet të përmbajë elementet bazë, si më poshtë:

- a) Përgjegjësinë dhe kontrollin nga ana e bordit të drejtorëve;
- b) Përgjegjësinë dhe kontrollin nga Komiteti për Rrezikun Operacional;
- c) Rolin dhe përgjegjësitë e menaxhmentit të lartë;
- d) Strukturë organizative të përshtatshme që identifikon autoritetin dhe përgjegjësitë e secilit brenda bankës;
- e) Politikat, procedurat dhe metodat për menaxhimin e rrezikut operacional; dhe
- f) Kërkesat mbi provizionimin e kapitalit për rrezikun operacional.

Neni 4

Mbikëqyrja dhe kontrollimi

1. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë të bankës duhet ta trajtojnë rrezikun operacional si një rrezik të madh dhe ata duhet të pranojnë përgjegjësinë përfundimtare të monitorimit të efikasitetit të menaxhimit të rrezikut operacional brenda bankës.

Neni 5

Përgjegjësitë e bordit drejtues dhe komitetit për menaxhimin e rrezikut operacional

1. Bordi Drejtues i bankës është përgjegjës për krijimin, aprovimin dhe rishikimin vjetor të politikave të rrezikut operacional. Bordi drejtues duhet të mbikëqyr menaxhmentin e lartë për të siguruar implementimin efektiv të politikave, proceseve dhe sistemeve, në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Gjithashtu, Bordi drejtues duhet të aprovoj dhe rishikoj tolerancën dhe mundësinë e rrezikut operacional. Bordi drejtues është përgjegjës për:

- a) Themelimin e strukturës organizative të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional;
- b) Zhvillimin e strategjive dhe politikave të përgjithshme për menaxhimin e rrezikut operacional, në linjë me qëllimet strategjike të bankës;
- c) Rishikimin dhe aprovimin e funksioneve të menaxhmentit të lartë, autorizimin dhe rregullimin e raportimit në lidhje me menaxhimin e rrezikut operacional, me qëllim të sigurimit të një sistemi efikas të vendimmarrjes në bankë dhe sigurimi se rreziku operacional me të cilin ballafaqohen operacionet e bankës, kontrollohen brenda kapaciteteve ekzistuese.

- d) Rishikimin e rregullit të raporteve mbi rrezikun operacional, të dorëzuara nga ana e menaxhmentit të lartë, të kuptojë menaxhimin e rrezikut operacional në bankë dhe efikasitetin e menaxhmentit të lartë në parandalimin e ngjarjeve të rëndësishme (materiale) të rrezikut operacional; si dhe monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit ditor të menaxhimit të rrezikut operacional.
- e) Të sigurohet se menaxhmenti i lartë ndërmerr masat e nevojshme që në mënyrë efektive identifikon, vlerëson, monitoron dhe kontrollon/zvogëlon rrezikun operacional.
- f) Të sigurohet se sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional në bankë, në mënyrë efektive është shqyrtuar dhe audituar nga ana e auditimit të brendshëm; dhe
- g) Të ketë një sistem të përshtatshëm të shpërblimit-ndëshkimit që në mënyrë efektive të promovoj zhvillimin e një sistemi të menaxhimit të rrezikut operacional, në tërë bankën.

Neni 6

Përgjegjësitë e menaxhmentit të lartë

1. Menaxhmenti i lartë në një bankë është përgjegjës për implementimin e strategjive të menaxhimit të rrezikut operacional, politikave të përgjithshme dhe funksionimin e sistemeve të aprovuara nga Bordi i Drejtoreve.

Menaxhmenti i lartë duhet të:

- a) Raportoje rregullisht Bordit të Drejtoreve në lidhje me menaxhimin e vazhdueshëm të rrezikut operacional.
- b) Përpiloje dhe rregullisht rishikoj politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut operacional, dhe proceset e detajzuara në pajtim me strategjitë dhe politikat e përgjithshme të zhvilluara nga ana e Bordit, mbikëqyr implementimin e tyre, dhe i paraqet raporte mbi menaxhimin e rrezikut operacional në baza të rregullta, Bordit të Drejtoreve.
- c) Të kuptojë mjaftueshëm menaxhimin e rrezikut operacional në bankë, posaçërisht ngjarjet apo programet që paraqesin rrezik operacional material (të rëndësishëm).
- d) Në mënyrë të qartë të definojë përgjegjësitë e secilit departament në menaxhimin e rrezikut operacional, e po ashtu edhe definimin e linjave raportuese, shpeshësinë dhe përmbajtjen e raportit, të nxis secilin departament që të përcaktoj përgjegjësitë e tyre në mënyrë që të sigurojë performancë të shëndoshë të sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional.
- e) Pajis funksionin e menaxhimit të rrezikut operacional me resurset e nevojshme, duke përfshirë por jo kufizuar në fondet e nevojshme, krijimi i pozitave të nevojshme me staf të pranueshëm, ofrimi i kurseve trajnuese për personelin e menaxhimit të rrezikut operacional, delegimi i autorizimeve personelit të sipërpërmendur, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tyre, etj, dhe

- f) Bën kontrolle dhe revizione të sakta në sistemin e menaxhimit të rrezikut operacional me qëllim që në mënyrë efektive t'i përgjigjet ngjarjeve të rrezikut operacional, si pasojë e ndryshimeve të brendshme në procedura, produkte, aktivitete biznesore, sisteme të teknologjisë informative, personelit, ngjarjeve të jashtme apo faktorëve të tjerë.

2. Bankat duhet të krijojnë një departament apo njësi të posaçme, i cili do të jetë përgjegjës për krijimin dhe implementimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional. Ky departament duhet të jetë i pavarur nga departamentet e tjera me qëllim të sigurimit të konsistencës dhe efikasitetit të sistemit. Përgjegjësitë e këtij departamenti duhet të përfshijnë:

- a) Hartimin e politikave, procedurave dhe proceseve të veçanta të menaxhimit të rrezikut operacional dhe dorëzimi i tyre Menaxhmentit të Lartë dhe Bordit të Drejtorëve, për rishikim dhe aprovim.
- b) Asistimi për departamentet tjera në identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe kontrollimin/zvogëlimin e rrezikut operacional.
- c) Krijimi i metodave me qëllim të identifikimit, vlerësimit, zvogëlimit (përfshirë edhe kontrollet e brendshme) dhe monitorimit të rrezikut operacional, formulimi i një procesi raportues në tërë bankën sa i përket rrezikut operacional, organizimit dhe implementimit të tij.
- d) Vendosja e kritereve bazë mbi rrezikun operacional në tërë bankën, duke udhëzuar dhe koordinuar menaxhimin e rrezikut operacional.
- e) Organizon trajnime për secilin departament në lidhje me menaxhimin e rrezikut operacional, si dhe iu ndihmon atyre të përmirësojnë kapacitetet mbi menaxhimin e rrezikut operacional dhe përmbushjes së detyrave të tyre.
- f) Në baza të rregullta kontrollon dhe analizon praktikat e menaxhimit të rrezikut operacional në departamentet biznesore dhe në departamente tjera të bankës.
- g) Në baza të rregullta dërgon raporte mbi rrezikun operacional, tek Menaxhmenti i Lartë; dhe
- h) Siguroj se sistemet për matjet e menaxhimit të rrezikut operacional janë vëzhguar.

3. Departamentet relevante, në banka duhet të jenë përgjegjëse të drejtpërdrejta për menaxhimin e rrezikut operacional. Përgjegjësitë kryesore përfshijnë:

- a) Emërimi i stafit të caktuar i ngarkuar me menaxhimin e rrezikut operacional, duke përfshirë vëzhgimin e politikave, procedurave dhe proceseve të posaçme për menaxhimin e rrezikut operacional.
- b) Përcjellja e metodave të vlerësimit për menaxhimin e rrezikut operacional me qëllim të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut operacional nëpër departamente, dhe të ketë një procedurë të vazhdueshme efikase të monitorimit, kontrollimit/zvogëlimit dhe të raportojë rreziqet operationale, e më pas të organizoj implementimin e tyre.

- c) Të marr në konsideratë kërkesat e menaxhimit të rrezikut operacional dhe kontrolleve të brendshme, veçanërisht kur krijohen procese të veçanta biznesore të departamenteve, që të siguroj se personeli i menaxhimit të rrezikut operacional, në të gjitha nivelet, merr pjesë në rishikimin dhe aprovimin e procedurave, kontrolleve dhe politikave të rëndësishme, dhe kështu ti harmonizoj me politikat e përgjithshme të bankës në menaxhimit të rrezikut operacional; dhe
- d) Monitoron treguesit më të rëndësishëm të rreziqeve dhe rregullisht i raporton gjendjen në menaxhimit të rrezikut operacional të departamentit të tyre të departamenti i cili është i përgjegjës dhe ka rol udhëheqës në menaxhimit të rrezikut operacional në tërë bankën.

4. Zyra ligjore, zyra e pajtueshmërisë, departamenti i teknologjisë informative, si dhe resurset humane të një banke duhet që përveç menaxhimit adekuat të rrezikut të vet operacional, të ofrojnë resurse të përshtatshme dhe asistencë brenda mundësive të tyre dhe përgjegjësiive respektive, departamenteve tjera, me qëllim të menaxhimit të rrezikut operacional.

5. Departamenti i auditimit të brendshëm i një banke nuk është përgjegjës i drejtpërdrejtë apo nuk merr pjesë në menaxhimit të rrezikut operacional, por duhet që rregullisht të kontrolloj dhe vlerësojë se si po operon sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional, mbikëqyr implementimin e politikave të menaxhimit të rrezikut operacional, në mënyrë të pavarur i vlerëson këto politika, procedura dhe proceset e veçanta të reja të menaxhimit të rrezikut operacional të bankës dhe i raporton Bordit të Drejtorëve rezultatet e vlerësimit të sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional.

6. Një bankë me aktivitet kompleks dhe shkalle të lartë afarizmi, mund t'i besoj ndonjë agjensionin ndërmjetës, auditimin dhe vlerësimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional, në mënyrë të vazhdueshme.

7. Një bankë duhet të zgjedh qasjen më të përshtatshme, me qëllim të menaxhimit të rrezikut operacional, i cili mund të përfshijë: vlerësimin e rrezikut operacional dhe kontrolleve të brendshme, raportimi i ngjarjeve të cilat kanë rezultuar me humbje dhe mbledhja e të dhënave, monitorimi i treguesve kryesor të rrezikut, vlerësimi i rrezikut sa i përket produkteve të reja dhe praktikave afariste, testimi dhe auditimi i kontrolleve të brendshme, dhe raportimi i rrezikut operacional.

8. Një bankë me aktivitet kompleks dhe shkalle të lartë afarizmi, duhet të adaptojë metoda më të sofistikuara të menaxhimit të rrezikut (si p.sh. metoda kuantitative) me qëllim të vlerësimit të rrezikut operacional të secilit departament, të mbajë një bazë të të dhënave mbi rreziqet operationale të rezultuara me humbje, dhe të bëjë rregullime në pajtim me karakteristikat e rrezikut operacional, lidhur me secilën linjë të biznesit.

9. Një bankë duhet të zhvillojë një proces efektiv që rregullisht të monitoroj dhe raportoj statusin e rrezikut operacional dhe humbjet materiale. Për rreziqet me potencial për rritje të humbjeve, duhet të krijohet një sistem i lajmërimit të hershëm të rrezikut operacional me qëllim të kontrolloj zvogëlimin e rrezikut dhe zvogëlimin e ngjarjeve të ndryshme që mund të rezultojnë me humbje.

10. Një bankë duhet të krijojë dhe gradualisht të përmirësojë sistemin informativ të menaxhimit të rrezikut operacional, me qëllim që në mënyrë efikase të identifikojë, kontrollojë dhe raportojë rreziqet operationale. Ky sistem, së paku duhet që të regjistrojë dhe

ruaj datën e ngjarjeve dhe humbjet nga rreziku operacional. Sistemi duhet të bazohet në vetë-vlerësimin e rrezikut operacional dhe masat e kontrollit, monitorimin e indikatorëve kyç të rrezikut dhe krijimin e informatave relevante të përfshira në një raport të rrezikut operacional.

Neni 7

Qasjet për kalkulimin e kapitalit për rrezikun operacional

1. Kërkesat për kapital për rrezikun operacional duhet të jetë shuma e kalkuluar duke përdorur:

- a) Qasjen e treguesit bazik – QTB (BIA- Basic Indicator Approach), ose
- b) Qasjen e standardizuar – QS (SA- Standardised Approach), ose

a) Qasja sipas treguesit bazik

Sipas Qasjes së treguesit bazik, kërkesat për kapital për rrezikun operacional është e barabartë me 15% të treguesit relevant.

1. Tregues relevant është mesatarja gjatë tre viteve të shumës së të hyrave neto nga interesi dhe neto të hyrat jo nga interesi.

2. Mesatarja e tre viteve kullohet mbi bazën e tre dymbëdhjetë mujorëve të periudhave të fundit, në fund të vitit financiar. Kur të dhënat e audituara nuk janë në dispozicion, vlerësimet nga banka mund të përdoren.

Me rastin e kalkulimit të shumës së të hyrave neto nga interesi dhe neto të hyrat jo nga interesi, bankat duhet të përdorin elementet si më poshtë:

- a) të hyrat nga interesi
- b) shpenzimet nga interesi
- c) të hyrat nga dividenda
- d) të hyrat nga provizionet dhe komisionet
- e) shpenzimet nga provizionet dhe komisionet
- f) fitimi/humbja neto nga operacionet financiare, përfshirë:
 - fitimi/humbja neto nga pasuritë financiare dhe detyrimet, me qëllim tregtimi
 - fitimi/humbja e realizuar neto nga pasuritë financiare dhe detyrimet, të cilat nuk maten në vlerën fer përmes pasqyrës së të ardhurave, nëse janë rezultat i zërave të librit tregtues
 - fitimi/humbja e realizuar neto nga pasuritë financiare dhe detyrimet, të njohura në vlerën fer përmes pasqyrës së të ardhurave, nëse janë rezultat i zërave të librit tregtues
 - ndryshimet në vlerën fer gjatë kalkulimit të zvogëlimit të rrezikut
 - fitimi/humbja neto nga diferenca e kursit të këmbimit nëse janë si rezultat i zërave të librit tregtues dhe nëse nuk janë përfshirë në paragrafët e mësipërme të pikës f).
- g) të hyrat tjera operationale

Gjatë kalkulimit të shumës së të hyrave neto nga interesi dhe të hyrave neto jo nga interesi, zërat të cilët në përmbajtje konsiderohen të hyra të jashtëzakonshme apo zëra jo të rregullt, apo të hyra nga kërkesat e sigurimit, duhet të përjashtohen.

Shpenzimet e provizioneve dhe komisioneve për palët e jashtme, duhet të përfshijnë provizionet (komisionet) e paguara kompanisë amë apo degës së një institucioni kreditor apo

një dege të kompanisë amë, e cila gjithashtu është kompani amë e institucionit kreditor, derisa shpenzimet dhe provizionet palëve të jashtme nuk janë të përfshira në shpenzimet e provizioneve dhe komisioneve. Shpenzimet e provizioneve dhe komisioneve palëve të jashtme përfshihen në bazën e kalkulimit të kërkesave për kapital për rrezikun operacional (të përfshira në shpenzimet e provizioneve dhe komisioneve) nëse përfshin pagesën për një entitet, i cili është subjekt i mbikëqyrjes (në pajtim me provizionet e Direktivës Evropiane 2006/48/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian).

3. Nëse për ndonjë periudhë të caktuar, shuma e të hyrave neto nga interesi dhe të hyrave neto jo nga interesi është negative apo e barabartë me zero, kjo shifër nuk duhet të merret parasysh në kalkulimin e mesatares tre-vjeçare. Treguesi relevant duhet të kullohet si shumë e të dhënave pozitive, pjesëtuar me numrin e të dhënave pozitive.

b) Qasja e standardizuar

1. Nën Qasjen e Standardizuar, kërkesa për kapital për rrezikun operacional është mesatarja tre-vjeçare e treguesve relevant të rrezikut të peshuar, e kalkuluar çdo vit përmes linjave biznesore. Secilin vit, kërkesa negative për kapital nga një linjë biznesore, rezultuar nga treguesi relevant negativ, mund të numërohet në tërësi. Sidoqoftë, kur ngarkesa e përgjithshme për kapital, në të gjitha linjat biznesore, në një vit të caktuar është negative, atëherë inputi për mesataren e atij viti duhet të jetë zero (linjat biznesore janë të definuara në Rregulloren mbi adekuatshmërinë e kapitalit).

2. Kërkesat vjetore për kapital kullohen si shumë e kërkesës për kapital për të gjitha linjat e biznesit.

3. Kërkesa për kapital për një linjë specifike biznesore duhet të jetë e barabartë me përqindjen nga produktin e përqindjes, e definuar për atë linjë biznesore dhe bazës së saj për kalkulim të kërkesave për kapital për rrezikun operacional.

a) Baza për kalkulimin e kërkesave për kapital për rrezikun operacional, sipas qasjes së standardizuar, kullohet ndaras për secilën linjë biznesore dhe për secilin vit, duke marrë në konsideratë kalkulimin e mesatares, të përshkruar më lartë.

b) Baza për kalkulimin e kërkesave për kapital për rrezikun operacional për një linjë specifike biznesore, kalkuluar sipas qasjes së standardizuar, duhet të jetë shuma e të hyrave neto nga interesi dhe neto të hyrave nga jo interesi.

c) Kur të dhënat e audituara nuk janë në dispozicion, vlerësimet nga banka mund të përdoren.

d) Metodologjitë për kalkulimin e shumës së të hyrave neto nga interesi dhe të hyrave neto jo nga interesi duhet të aplikohen, siç janë përshkruar më sipër.

4. Bankat mund ta zgjedhin qasjen për kalkulimin e kërkesave për kapital për rrezikun operacional, megjithatë, nëse banka dëshiron ta ndryshoj kalkulimin e saj për kërkesat për kapital për rrezikun operacional në qasjen tjetër, ajo mund ta bëjë atë vetëm me aprovimin paraprak të BQK-së. Ky aprovim do të bëhet vetëm nëse ekziston arsye e fortë për ta përdorur qasjen tjetër. Në çdo rast, me aprovimin të ndryshimit të kullimeve, BQK-ja do ta përcaktojë datën për ndryshimin në qasjen tjetër të kalkulimit.

5. Kalkulimet e kapitalit për rrezikun operacional duhet të bëhen ashtu siç është e përcaktuar në Rregulloren mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

Neni 8 Klasifikimi i llojeve të ngjarjeve me humbje

Tabela

Ngjarja – lloji i kategorisë	Definicioni
Mashtrimet e brendshme	Humbjet si shkak i veprimeve të llojeve të paramenduara të mashtrimit, përvetësimit të pasurisë apo shmangies së rregulloreve, ligjit apo politikave të kompanisë, duke përfshirë ngjarjet e diskriminimit/diversitetit, e cila përfshin të paktën një palë të brendshme.
Mashtrimet e jashtme	Humbjet si shkak i veprimeve të llojeve të paramenduara të mashtrimit, përvetësimit të pasurisë apo shmangies së ligjit nga palët e treta.
Praktikat e punësimit dhe siguria në punë	Humbjet e shkaktuara nga veprimet e papajtueshmërisë me ligjet apo marrëveshjet për punë, shëndet apo siguri në punë, nga pagesat personale të kërkesave për dëmtim, apo ngjarjet e diskriminimit/diversitetit.
Produktet për klientë dhe praktikat afariste	Humbjet e shkaktuara nga dështimi pa dashje apo nga pakujdesia për të përmbushur obligimet profesionale ndaj një klienti specifik (duke përfshirë kërkesat e mirëbesimit dhe përshtatshmërisë) apo nga natyra ose dizajni i produktit.
Dëmtimi i mjeteve fizike	Humbjet e shkaktuara nga humbja apo dëmtimi i mjeteve fizike nga fatkeqësitë natyrore apo ngjarje tjera.
Ndërprerja e afarizmit dhe rëniet e sistemit	Humbjet e shkaktuara nga ndërprerja e afarizmit apo rëniet e sistemit
Menaxhimi i Ekzekutimit, Dërgesave dhe proceseve	Humbjet nga procesimet e dështuara të transaksioneve apo menaxhimit të procesit, nga marrëdhëniet me palët tregtare dhe shitësit

Neni 9

Shënime sqaruuese të proceseve, sistemeve, njerëzve dhe rreziqeve të jashtme

1. *“Rreziku nga proceset”* - është mundësia e humbjeve si pasojë e procesimit të pakujdesshëm nga punëtorët, aksidenteve apo aktiviteteve të paautorizuara. Bankat, që operojnë në Republikën e Kosovës dhe të licencuara nga BQK-ja, duhet të punojnë në rritjen e nivelit të sofistikimit të menaxhimit të rrezikut të proceseve në tërë Bankën duke u siguruar që secila degë ndjek hulumtime të rregullta vetjake të rrezikut të proceseve; minimizimi i humbjeve në rast të gabimeve gjatë procesimeve apo pakujdesisë, duke hartuar plane kontingjente; dhe bartjes së kuantifikimit të plotë të rreziqeve nën menaxhmentin.

2. *“Rreziku nga Sistemet”* - është mundësia e humbjeve si pasojë e dështimeve, keqpërdorimeve apo shfrytëzimit të paautorizuar të sistemeve kompjuterike. BQK-ja ka parasysh se sistemet e qëndrueshme kompjuterike janë esenciale për një implementim efektiv të strategjisë së menaxhmentit nga pikëpamja e revolucionit të Teknologjisë Informative. Bankat duhet të kenë plane kontingjente me qëllim të minimizimit të humbjeve, në rast të dështimit (rënies) së sistemit. Zhvillimi i një sistemi të tillë të menaxhimit të rrezikut nga sistemet, siguron se banka si tërësi ka ndërmarr një menaxhim adekuat të rrezikut.

- a) Problemet të lidhura me kompjuterë në banka, tani kanë ndikim më të madh në publik, me rritjen e rrezikut nga sistemet si rezultat i revolucionit, zgjerimit të rrjetit dhe rritjes së numrit të shfrytëzuesve të kompjuterëve personal. Me qëllim të parandalimit të prishjes së sistemit, bankat duhet të ndërmarrin masa të ndryshme, duke përfshirë dyfishimin e sistemeve dhe infrastrukturave të ndryshme, mirëmbajtje konstante të sistemeve për të siguruar vazhdueshmëri, operacione të pandërprera, dhe krijimin e sistemit për parandalimin e fatkeqësive. Banka duhet ta ruaj besueshmërinë e informatave të klientëve dhe parandaloj daljen e informatave, informatat e ndjeshme duhet të jenë të koduara, hyrjet e paautorizuara nga jashtë të jenë të bllokuara, dhe të gjitha kundërmasat e njohura, me qëllim të sigurimit të të dhënave janë zbatuar. Gjithashtu, secila bankë duhet të ketë plan kontingjent dhe të mbajë sesione të trajnimeve, për të siguruar përgatitje të plotë, në rast të rasteve emergjente. Për të mirëmbajtur sigurinë, kundërmasat duhet të rishikohen edhe kur shfrytëzohet teknologjia e re.

4. *“Rreziku nga personeli”* – është pjesë përbërëse e vlerësimit të rrezikut operacional dhe bankat duhet ta marrin në konsiderim se deri në çfarë mase personeli i bankës mund të ndikoj në rrezikun e ekzekutimit të operacioneve afariste me strukturën ekzistuese.

Kjo përfshin madhësinë, kompleksitetin, dhe transparencën e bankës, kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e produkteve të saj dhe kompleksitetin e sistemeve të cilat i përdor për kryerjen e aktiviteteve të saj.

- a) Banka duhet të definoj strukturën e saj organizative dhe linjat e raportimit në mënyrë që të definojë pozitat e departamenteve përbrenda bankës, strukturën organizative të departamenteve dhe linja të mjaftueshme të qarta dhe drejtpërdrejta të raportimit.
- b) Gjithashtu, bankat duhet të marrin parasysh komunikimet me departamente tjera në menaxhimin se cilat të dhëna, raportet apo përgjegjësitë e menaxhimit të rrezikut lëvizin nëpër departamente; përcaktimin e funksioneve apo përshkrimet e vendeve të punës, aktivitetet e departamenteve dhe roli i menaxhmentit duhet të definohen qartë,

kualifikimet e stafit dhe menaxhmentit. Menaxhmenti dhe stafi kryesor duhet të jenë me përvojë.

- c) Bankat duhet ta konsiderojnë edhe rrezikun e vetvetishëm (natyral) i cili përfshin: shkallen e lëvizjes së stafit, shkallën e vendeve të lira të punës (konkurset), ndryshimet organizative, madhësia e stafit në relacion me vëllimin e aktiviteteve dhe mbështetja në stafin kryesor dhe progresin e menaxhimit.
- d) Bankat duhet ta konsiderojnë gjithashtu edhe rrezikun residual i cili përfshin: abuzimin me sistemin, abuzimin me informata të besueshme, konkurset për vende të lira të punës dhe koha e lënë vakant, shkalla e mashtrimeve të brendshme, shpenzimet e kërkesave të rreme etj.
- e) Bankat, në menaxhimin e resurseve njerëzore (personelit), duhet të ketë në konsideratë që rekrutimi i stafit të ri të bëhet me kompetencat e kërkuara, të jenë të vëmendshme me trajnimet, të pajis stafin me njohuritë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë efektive dhe të bëjë një program të lëvizjes së stafit, me qëllim të rinovimit të motivimit dhe eliminimit të rrezikut lidhur me aktivitetet përsëritëse.

5. “Ngjarjet e jashtme” – janë rreziqet që rrjedhin nga: krimet (vjedhjet) nga brenda/jashtë (mashtrimet, vjedhjet, plaçkitjet), ngjarjet elementare, katastrofat natyrore, terrori/lufta dhe rreziku politik. Ky lloj i rrezikut përfshin edhe rrezikun ligjor, i cili është rreziku i humbjeve pasi që një kontratë nuk mund të zbatohet ligjërisht, dhe gjithashtu përfshin edhe rrezikun që vjen si pasojë e dokumentacionit të pamjaftueshëm dhe autoritetit të pamjaftueshëm të palës tjetër.

Neni 10

Raportimet e rrezikut operacional

1. Bankat, në baza vjetore, duhet të raportojnë në BQK mbi politikat dhe procedurat mbi menaxhimin e rrezikut operacional dhe raportet në lidhje me rrezikun operacional. Bankat të cilat ia besojnë agjensioneve tjera auditimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional, gjithashtu duhet t’ia shpalsin raportet e auditimit BQK-së.

2. Bankat, menjëherë, duhet të raportojnë në BQK rreth ngjarjeve të rrezikut operacional, nëse ndodhin ndonjë nga ngjarjet në vijim:

- a) Krime financiare, në të cilat më shumë se €5,000 janë vjedhur nga banka , në rast të vjedhjes së automjeteve të bankës ose çfarëdo vjedhje e parave nga banka, mashtrime financiare ose raste tjera që paraqesin humbje për bankën në shumën monetare mbi €5,000,
- b) Ngjarje, të cilat rezultojnë në dëm serioz ose humbje të dhënave të rëndësishme të bankës, librave të saj, ndërprerje të operacioneve për më tepër se tri orë në dy apo më tepër degë/nëndegë, apo ndërprerje të operacioneve për më tepër se pesë orë në një degë dhe e cila ndikon në operacionet normale të bankës,
- c) Informatat ekskluzive të bankës janë vjedhur, shitur apo publikuar pa lejen e bankës apo ndonjë informacion i humbur i cili mund ta dëmtoj stabilitetin financiar të bankës.
- d) Shkelje të shpeshtë të rregullave të aplikueshme nga menaxhmenti i lartë,

- e) Aksidente apo katastrofa natyrore, të shkaktuara nga çfarëdo fuqie, e cila rezulton në humbje ekonomike të menjëhershme në shumë prej €10,000,
- f) Rreziqe tjera operacionale, që mund të rezultojnë në humbjen e më shumë se 0.5% të kapitalit neto të bankës, dhe
- g) Ngjarje tjera materiale, siç mund të specifikohen nga BQK-ja.

3. BQK-ja rregullisht do të kontrollojë dhe vlerësojë politikat, procedurat dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut operacional në banka. Pikat kryesore, të cilat do të kontrollohen dhe vlerësohen përfshijnë:

- a) Efektiviteti i procedurave të menaxhimit të rrezikut operacional,
- b) Aftësia e bankës për të monitoruar dhe raportuar rrezikun operacional, përfshirë treguesit kryesor të rrezikut (KRI) dhe të dhënat për humbjet nga rreziku operacional;
- c) Masat e bankës që në kohën duhur dhe në mënyrë efektive merret me ngjarjet e rrezikut operacional dhe lidhjeve të tjera dobëta (ang.weak links);
- d) Procedurat e kontrolleve të brendshme të bankës janë rishikuar dhe audituar brenda proceseve të menaxhimit të rrezikut operacional;
- e) Kualiteti dhe gjithë-përfshirja e planeve për rigjenerimin nga katastrofat e bankës dhe planeve të vazhdimësisë së biznesit, përfshirë edhe analizën për skenarët e ndryshëm.
- f) Niveli i adekuatshmërisë së provizionimit të kapitalit për rrezikun operacional; dhe
- g) Aspekte të tjera për menaxhimin e rrezikut operacional.

Neni 11

Zbatimet, masat përmirësuese dhe dënimet civile

1. Për problemet e rrezikut operacional të zbuluara gjatë ekzaminimit të BQK-së, banka duhet të dorëzojë planin për përmirësim dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme brenda afateve të përcaktuara nga BQK-ja.

2. Kur një ngjarje materiale e rrezikut operacional ndodh, dhe banka dështon të ndërmarrë masa efektive për përmirësimin e tyre brenda afateve të caktuara kohore, BQK-ja do të ndërmarrë veprime të duhura rregullative, në linjë me ligjet dhe rregulloret.

3. BQK-ja mund ti marr masat e parapara me Nenet 58,59 dhe 82 te Ligjit për Banka nëse vlerëson se Bankat nuk i kane respektuar dispozitat e kësaj rregullore

Neni 12

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet çdo dispozite tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 13
Hyrjes në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Sejdi Rexhepi